

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fitorja tronditëse e AfD në Gjermani, pse Elon Musk është entuziazmuar - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/fitorja-tronditese-e-afd-ne-gjermani-pse-elon-musk-eshte-entuziazmuar/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 11:34:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 11:34:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	875bab9188e4a69b1b7824479c51a2197c19a29e852d3297a142de20473b7f6d
TEKSTI	ea1869bd5e8710f6ef9d5ea45f7dfc42d64e706672ea7ec88185b2e1e4d42bba
PAMJA	6ccc015154e6acf78ed2833d389f909d520457b3cae0f291545437a847309a7e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bb401139dc5ccc7211b3115cf67766b357914df4da330d79096baa16c3683473
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5f8ef0f8d1c556c1a23c45b5f0b4a2927fefdb161a9dff8be1ca6faf0b0d4224
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bb401139dc5ccc7211b3115cf67766b357914df4da330d79096baa16c3683473>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Erion Veliaj SHBA GjKKO Gjykata e Lartë Alket Rizai

BOTA

Fitorja tronditëse e AfD në Gjermani, pse Elon Musk është entuziazmuar

15 Shtator 2026 | 13:34

Partia Alternativa për Gjermaninë (AfD) tronditi politikën evropiane këtë javë pas një fitoreje bindëse në zgjedhjet e një landi gjerman, duke u afruar vetëm disa vende nga formimi i qeverisë së parë të ekstremit të djathtë në nivel shteti që nga Lufta e Dytë Botërore.

Elon Musk u shpreh i entuziazmuar.

"Gut gemacht! (shumë mirë), shkroi Musk në X një javë më parë, duke uruar kryetaren e AfD'së, Alice Weidel. Ky ishte një nga të paktën një duzinë postimesh që CEO i Tesla dhe SpaceX bëri për AfD pas rezultatit.

AfD ia ktheu vlerësimin, me liderin e Saksoni?Anhalt, Ulrich Siegmund, që falënderoi Musk për mbështetjen. Siegmund, i cili kërkon që shkollat gjermane të fokusohen më pak tek përgjegjësia për Luftën e Dytë Botërore dhe stafi i tij kryesor përfaqëson katër ish?anëtarë të një grupi rinor neo?nazist të ndaluar, e quajti Musk një "vizionar".

Musk është bërë një figurë qendrore e ekstremit të djathtë global vitet e fundit, duke përdorur ndikimin e tij për të mbështetur aktivistë anti?emigrantë, liderë joliberalë dhe parti nacionaliste. Krahas obsesionit të tij me çështjet racore në Mbretërinë e Bashkuar, një pjesë e madhe e vëmendjes së tij është përqendruar tek AfD. Rezultatet e mëdha në zgjedhjet e Saksoni?Anhalt dhe gëzimi i Musk për fitoren e tyre kanë ringjallur vëmendjen mbi lidhjet e tij me këtë parti.

Lidhjet e Musk me AfD dhe ekstremistët e djathtë gjermanë paraprijnë votimin në Saksoni?Anhalt dhe përkohë me zhvendosjen e tij publike drejt së djathtës. Pikëpamjet e tij mbi emigracionin, politikën dhe racën, të shprehura pa ndërprerje në X, ndër vite janë bërë të padallueshme nga shumë politika të AfD'së. Duke e promovuar AfD'në dhe duke marrë adhurimin e tyre në këmbim, Musk dhe partia kanë zhvilluar një marrëdhënie simbiotike për të përhapur idetë e ekstremit të djathtë si në Gjermani, ashtu edhe në SHBA.

Forcimi i ekstremit të djathtë ndërkombëtar

Ndërsa Musk u përfshi më shumë në politikë në vitin 2024, duke mbështetur rizgjedhjen e Donald Trump me mbi 100 milionë dollarë nga pasuria e tij, ai krijoi aleanca me disa liderë të tjerë ndërkombëtarë të ekstremit të djathtë, të cilët mbajnë qëndrime anti?emigracion

LAJMI I FUNDIT

13:26 Dashuri në Tinder apo rrezik spiunazhi? Oficeri i NATO-s pezullohet pas lidhjes me gruan e lindur në Rusinë sovjetike

13:17 Kishte kultivuar 80 bimë kanabisi pranë banesës në Mallakastër, arrestohet 41-vjeçari

13:12 Një qytet në Britani vendos kufizime për mbulimin e fytyrës për të luftuar sjelljen antisociale

SHPËRNDAJE

ARTIKULLIN Papat e gjyqtarëve, ministri Gogu: Kuvendi humbi afatin, por zgjidhja bëhet me ligj

12:33 Ukraina nis kundërofensivën "Vivaldi" në Donetsk, rimerr territor dhe dëmton logjistikën ruse

12:22 Gjykata e Lartë e la në burg, reagon mbrojtja e Erion Veliajt

TESTIM

dhe kundërshtim ndaj institucioneve demokratike.

Musk u shfaq në skenë me presidentin argjentinas Javier Milei, i njohur për përdorimin e sharrës elektrike, i dorëzoi një çmim kryeministres ultrakonservatore të Italisë, Giorgia Meloni, më pas sulmoi gjyqtarët italianë që vendosën mbi të drejtat e emigrantëve dhe mbajti një fjalim të transmetuar drejtpërdrejt në një tubim të aktivistit britanik anti-Islam, Tommy Robinson, ku Musk deklaroi se emigracioni po shkaktonte “shkatërrimin e Britanisë”.

Ai gjithashtu u lidh me Naomi Seibt, një skeptike gjermane e krizës klimatike dhe aktiviste anti-emigracion, e cila shpesh postonte në X dhe ishte 24 vjeç në atë kohë. Musk filloi t’i dërgonte mesazhe personale pasi pa postimet e saj, tha Seibt për gazetarin Paul Ronzheimer të rrjetit Global Reporters të Axel Springer, dhe ajo i promovoi AfD-në në bisedat e tyre.

Në fund të vitit 2024, Musk shkroi një artikull opinion për median gjermane Die Welt, ku shprehu mbështetjen e tij për AfD. Ai argumentoi se Gjermania ishte në prag të një “kolapsi ekonomik dhe kulturor” që mund të zgjidhej vetëm nga AfD, të cilën e quajti “shkëndija e fundit e shpresës” për vendin. Musk shtoi se partia nuk ishte ekstreme, duke dhënë shembullin se liderja e saj, Weidel, ka një partnere të së njëjtës gjini nga Sri Lanka.

“Ju duket si Hitleri kjo?”, shkroi Musk.

Ndërsa Musk mori një rol të dukshëm në administratën e dytë të Trump në fillim të vitit 2025, ai përdori platformën dhe fuqinë e tij politike për të forcuar më tej AfD-në. Në janar të atij viti, Musk organizoi një transmetim të drejtpërdrejtë për Weidel, që sipas studiuesve i dha asaj një rritje të madhe në platformë dhe solli një shtim të mbulimit në mediat gjermane.

“Musk pati realisht një efekt në vendosjen e agjendës së mediave tradicionale në Gjermani”, tha Jan Rau, studiues në Institutin e Kërkimeve për Kohezion Social dhe Institutin Leibniz për Kërkime Mediatike. “Kjo u pa shumë qartë. Pati një shpërthim të vëmendjes nga mediat tradicionale për Weidel në atë moment dhe një pjesë e madhe e kësaj vëmendjeje lidhej drejtpërdrejt me Musk.”

Javë pas transmetimit me Weidel, Musk u shfaq sërish përmes livestream në një tubim të AfD-së. Vetëm disa ditë pasi shkaktoi polemika duke bërë përhëndetje në stil fashist në një tubim inaugurues të Trump, Musk i tha turmës së AfD në Gjermani se kishte “shumë fokus tek faji i së kaluarës dhe duhet të ecim përtej saj”. Komentet e tij sollën dënime nga liderët hebrej dhe akuza se po përpiqej të normalizonte ekstremizmin e djathtë.

Kufijtë e ndikimit të Musk

Afërsia e tij me Trump dhe roli i dukshëm në Shtëpinë e Bardhë pas zgjedhjeve të vitit 2024 e shtuan fuqinë politike të Musk, si dhe frikën e qeverive të huaja se ai po ndërhynte në punët e tyre kombëtare.

Pas blerjes së Twitter në vitin 2022, Musk bëri disa ndryshime që ndihmuan në përf forcimin e politikave përçarëse të ekstremit të djathtë, si ato të AfD-së. Ai riktheu llogari të ndaluara më parë, përfshirë aktivistin austriak pro-AfD dhe anti-emigracion Martin Sellner, i cili ka marrë meritën për futjen e politikave nacionaliste të “rimigrimit” dhe shpesh promovoi llogari ndërkombëtare të djathta përmes ripostimeve.

“Ndryshimet që bëri Musk në platformë e bënë shumë më të lehtë komunikimin e ekstremit të djathtë”, tha Rau. “Kjo është e dobishme për AfD në shumë mënyra”.

Por studiuesit, përfshirë Rau, argumentojnë se fluska e djathtë që Musk ka krijuar në X ka kufijtë e saj. Vetëm rreth 5% e gjermanëve përdorin X për të gjetur lajme, sipas një sondazhi të Institutit Reuters në vitin 2026 dhe shumë figura kryesore në vend e kanë braktisur publikisht platformën. Ndërsa disa nga mbështetjet e Musk për AfD kaluan në vëmendjen e mediave kryesore, pjesa më e madhe e tyre muajt e fundit ka mbetur e kufizuar tek audienca e tij e kapur në X.

Sot, Musk është shumë i papëlqyer në Gjermani. Një sondazh i YouGov vitin e kaluar tregoi se vetëm 19% e vendit kishte një mendim pozitiv për miliarderin, ndërsa edhe më pak, vetëm 13%, e shihnin të pranueshme përpjekjet e tij për të ndikuar në politikën gjermane. Madje edhe brenda AfD-së, Musk nuk është një prani e mirëpritur plotësisht.

“Musk nuk është gjithmonë ndihmues”, tha Oliver Marsh, studiues i pavarur dhe ish-anëtar i organizatës jofitimprurëse Algorithm Watch. “Shumë pjesëtarë të partisë janë nacionalistë tradicionalë gjermanë dhe nuk e miratojnë një miliarder amerikan që ndërhyr në politikën gjermane”.

Megjithëse ngritja e AfD lidhet më shumë me politikën e brendshme dhe dinamikat sociale të Gjermanisë sesa me Musk, kjo nuk e ndaloi atë të merrte pak meritë për suksesin e tyre. Musk ripostoi një koment nga një analist mediatik i djathtë gjerman, i cili pretendonte se pronësia e tij mbi X kishte shkaktuar një “ndryshim atmosfere” që çoi në fitoren e AfD-së.

Musk mbron AfD si ‘qendër ekstreme’

Në ditët pas fitores së AfD në zgjedhjet e landit Saksoni-Anhalt, Musk jo vetëm që festoi rezultatin, por edhe u përpoq të pohonte se partia nuk ishte aspak ekstremiste e djathtë, por ideologjikisht e moderuar. Ai postoi se partia, të cilën agjencia e inteligjencës së brendshme gjermane e kishte cilësuar vitin e kaluar si grup ekstremist të djathtë, duhej konsideruar si “qendër ekstreme”.

Musk gjithashtu kundërshtoi përshkrimet e mediave amerikane që e etiketuan AfD si ekstremiste të djathtë, pavarësisht pikëpamjeve të dokumentuara të partisë mbi emigracionin, Islamin dhe të drejtat LGBTQ+. Ai postoi disa përgjigje ndaj Wall Street Journal dhe CBS News pas zgjedhjeve, duke i akuzuar për përdorimin e termit “far right”.

“Ju po gënjeni duke e quajtur AfD ‘ekstremiste të djathtë’,” iu përgjigj Musk një postimi të CBS News në X, duke shtuar në një tjetër postim se “‘far right’ është një term propagandistik”.

Platforma e AfD përfshin ndalimin e shfaqjeve publike të besimeve islame; kundërshton martesat dhe birësimet e të njëjtës gjini, pavarësisht se Weidel ka një partnere femër nga Sri Lanka me të cilën rrit fëmijë; thekson identitetin etnik gjerman dhe bën thirrje për deportime masive. Liderët e AfD kanë marrë kritika ndër vite për minimizimin e Holokaustit dhe referenca provokuese ndaj nazizmit, me një nga anëtarët kryesorë të partisë të dënuar në vitin 2024 për përdorimin e një slogani të krahut paramilitar nazist gjatë një tubimi.

Weidel ndërkohë ka pohuar se ekziston “një luftë e shenjtë kundër popullsisë gjermane” duke bërë thirrje për “rimigrim”, një term për dëbime masive, dikur i përdorur nga ekstremistët e djathtë dhe nacionalistët e bardhë, që tani është përqafuar nga partitë nativiste si dhe nga Musk e Donald Trump.

Kancelari gjerman Friedrich Merz reagoi ndaj fitores së AfD këtë javë duke paralajmëruar se synimet e vërteta të partisë përbënin pastrim etnik, një karakterizim që partia e ekstremit të djathtë e mohoi.

“Nëse ajo që po avokohet këtu, pra ‘rimigrimi’, do të bëhej realitet, nuk do të ishte gjë tjetër veçse një sinonim për pastrim etnik bazuar në origjinë dhe ngjyrë lëkure”, tha Merz.

Musk sërish mbrojti AfD-në, duke ripostuar një përdorues që kritikonte akuzën e Merz përpara mbi 241 milionë ndjekësve të tij.

Qëndrimet e Musk, që përfshijnë një fiksion mbi racën dhe kundërshtim të zëshëm ndaj emigracionit, janë bërë gjithnjë e më të ngjashme me ato të Weidel dhe AfD.

“Kushdo që kundërshton rimigrimin është tradhtar”, postoi ai në korrik./ **Nick Robins-Early - The Guardian**

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

Dashuri në Tinder apo rrezik spiunazhi? Oficeri i NATO-s pezullohet pas lidhjes me gruan e lindur në Rusinë sovjetike

Një njohje përmes aplikacionit Tinder është kthyer në çështje sigurie për NATO-n, pasi një oficer i lartë i Marinës Spanjolle krijoi një marrëdhënie me një...

13:26 | 15/09/2026

BOTA

Një qytet në Britani vendos kufizime për mbulimin e fytyrës për të luftuar sjelljen antisociale

Kufizimet për mbajtjen e maskave të fytyrës në qendër të qytetit të Nottinghamit hynë në fuqi të martën, ndërsa autoritetet kërkojnë të luftojnë krimin, frikësimin...

13:12 | 15/09/2026

BOTA

Ukraina nis kundërofensivën “Vivaldi” në Donetsk, rimerr territor dhe dëmton logjistikën ruse

Forcat ukrainase kanë nisur një operacion ofensiv në veri të rajonit lindor të Donetskut, pika qendrore e betejave të ashpra gjatë më shumë se katër...

12:33 | 15/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit

[Bota](#)
[Video](#)

[Na ndiqni](#)
[Euronews Radio](#)
[Për persona me aftësi të kufizuara](#)

[Politika e cookie](#)
[Kontaktoni](#)
[Punësimi](#)

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.